

**Hartezimi i kapaciteteve per ekzaminime kolposkopike dhe ndjekjen e
grave HPV pozitive**

**Ne kuader te Programit Kombetar te depistimit te kancerit te qafes se
mitres**

**Shkurt
2021**

Ky raport eshte pergatitur nga:

Alban Ylli

Kozeta Filipi

Mirela Rista

Albana Fico


Raporti u be i mundur vetem ne saje te ndihmes se specialisteve obsteter gjinekologe dhe mjekeve te tjere ne spitalet rajonale, ne ato universitare dhe prane operatoreve te kujdesit shendetsor. Emrat e tyre jane renditur ne aneksin e raportit.

Hyrje: Konteksti lidhur me kontrollin e kancerit te gjirit ne Shqiperi

Rezultatet dhe ndryshimet e verejtura

Gjatë dekadës së fundit, pas intensifikimit të përpjekjeve për ngritjen e programeve sistematike të parandalimit dhe forcimin e kapaciteteve të sistemit shëndetësor për diagnoze të hershme, aktivitetet që synojnë përmirësimin e vetëdijes së grave shqiptare për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, kanë pasur sukses të konsiderueshëm. Megjithë ndryshimet gjeografike, përqindja e grave në moshë riprodhuese që kanë njohuri për parandalimin e këtij kanceri është rritur me më shumë se 55% në 2018 në krahasim me 10 vjet më parë. Kjo rritje është akoma më e madhe në zonat rurale.

Proporcioni i grave 15-49 vjeç që ka njohuri mbi parandalimin e kancerit të qafës së mitrës



Në fund të Janarit 2019, Qeveria Shqiptare mori vendimin e rëndësishëm për krijimin e programit të parë kombëtar të organizuar për depistimin e kancerit të qafës së mitrës. Programi fillestar synon gratë 40-50 vjeç. Synimi është të sigurojmë të gjitha grave në këtë grupmoshë teste të ekzaminimit për Hr-HPV, si pjesë e ekzaminimeve rutine të ofruara në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor. Programi i depistimit do të përmirësojë identifikimin e grave që janë në rrezik për kancer të qafës së mitrës, zbulimin në kohë të lezioneve prekanceroze dhe trajtimin e tyre në kohën e duhur. Sipas programit të ri, të gjitha testet primare të depistimit dhe ekzaminimet e mëtejshme do të sigurohen pa pagesë, pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor të pacientëve.

Për të minimizuar ngarkesën e shtuar të punës që sjell çdo program depistimi, infermierët në shërbimet e KSHP po marrin më shumë përgjegjësi nga mjekët e përgjithshëm. Për më tepër, testet e depistimit të bazuara në vetë marrjen e mostrave janë shumë praktike për gratë dhe garantojnë ngarkesë minimale të punës për ofruesit e shërbimeve.

Aktoret, mjedisi dhe sistemi

Që nga nënshkrimi i Deklaratës së Urtësisë në 2014, duket se në Shqipëri politikat dhe investimet në fushën e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës gëzojnë një mbështetje të madhe politike. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbetet aktori kryesor dhe pritet të vazhdojë të sigurojë lidhësi në forcimin dhe zgjerimin e programit ekzistues. Ndërkohë, ISHP me rolin e tij qendror në programet e parandalimit dhe shëndetit publik, ka treguar se është një aktor tjetër i rëndësishëm. Kështu, analizat e bazuara në fakte, të shoqëruara me rritjen e vetëdijes publike për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, kanë ndihmuar për të bindur MSHMS të ofrojë udhëheqjen e nevojshme për programin, të hartojë kornizën politike shëndetsore dhe të përfshijë të gjithë qeverinë në këto kauza.

Programi kombëtar i depistimit nuk mund të jetë as efektiv, as etik pa përfshirjen e plotë të kujdesit shëndetësor të specializuar, kryesisht në gjinekologji dhe biopsi. Dy spitalet universitare gjinekologjike dhe obstetrike në Tiranë janë thelbësore jo vetëm në sigurimin e diagnozave dhe trajtimin e rasteve pozitive për Hr-HPV, por edhe në mbështetjen e spitaleve të tjerë rajonal për forcimin e kapaciteteve të tyre, duke ulur në këtë mënyrë barrierat gjeografike për gratë gjatë vizitave në spital.

Programi i depistimit është duke u zbatuar përmes koordinimit të roleve të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, dhe institucioneve rajonale të shëndetit publik, duke siguruar akses maksimal në shërbimet e depistimit për popullatën target. Ky model i organizimit ndër-institucional duhet të përdoret në të ardhmen për komponentët e tjerë të programeve të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës, siç është vaksinimi kundër HPV.

Programi i ri kombetar. Situata ne vitin e pare te zbatimit

Programi kombetar i depistimit te kancerit te qafes se mitres ne Shqiperi bazohet ne Dekretin e Keshillit te Ministrave Nr. 47 (30.1.2019). Programi kombetar i depistimit perdor si ekzaminim primar testimin per HPV me risk te larte. Programi fillestar synon grate 40-50 vjeç. Qellimi eshte te sigurohet qe brenda pese vjetesh, te gjitha grate ne kete grupmoshe, te mund te bejne nje test te depistimit te Virusit te Papilomes Humane(HPV) me rrezik te larte, si pjese e ekzaminimeve rutine te bera ne qendrat e kujdesit shendetesor paresor (KSHP).

Programi i depistimit do te permiresoje identifikimin e grave qe jane ne rrezik me te larte per kancer te qafes se mitres, do te zbuloje me kohe demtimet para-kanceroze dhe do t'i trajtoje ato ne perputhje me protokollet perkatese te ndjekjes dhe kurimit. Sipas programit te ri, te gjitha testet e depistimit primar dhe ekzaminimet e metejshme do te sigurohen falas ne piken e kujdesit, pavaresisht nga statusi i sigurimit shendetesor te pacienteve.

Mbi bazen e kornizes teknike te programit kombetar i depistimit, çdo mjek i qendres shendetesore referon grate qe kane dale pozitive, per te kryer nje kolposkopi diagnostike te nje gjinekolog i kualifikuar dhe, kur eshte e nevojshme, citologji ose biopsi. Programi lejon diagnostikimin e fazave para kanceroze, trajtimin e tyre dhe parandalimin e kancerit te qafes se mitres.

Programi kombetar i depistimit eshte ne perputhje me nje numer politikash shendetesore kombetare, duke perfshire Programin Kombetar te Kancerit, Planin e Kontrollit te Semundjeve jo te trasmetueshme (NCD) dhe Strategjine e Shendetit Riprodhues. Ai eshte gjithashtu ne perputhje me dokumentet perkatese nderkombetare ne kete fushe.

Gjate periudhes shkurt-qershor 2019, Ne bashkepunim me ACPD dhe me mbeshtetjen e UNFPA, 538 profesioniste shendetesore nga rreth 400 qendra shendetesore u trajnuan ne te gjitha vendin per te pergatitur qendrat shendetesore paresore dhe sistemin e shendetit publik per zbatimin e programit kombetar te depistimit. Deri ne Janar 2020, nga rreth 14000 kite testesh te shperndara ne qendrat shendetesore u mblodhen me shume se 13500 mostra. Ne Laboratorin e Biologjise Molekulare IPH, te gjitha mostrat vaginale te mbledhura u testuan dhe pergjigjet nominale u shperndane ne cdo mjek familje.

Nga mostrat e testuara, 6.1% ishin pozitive per HPV me risk te larte (HR-HPV).

Gjate gjithë vitit 2019 dhe muajt e pare te 2020, ISHP koordinoi te gjithë programin dhe ofroi ekspertize teknike dhe mbështetje logjistike kur ishte e nevojshme. Edhe pas peridhes se lockdown te pranveres se 2020 me mbështetjen e ACPD, ISHP vijoi me shpërndarjen e gjithë materialeve te testimit ne qendrat shëndetësore ne përputhje me nevojat.

Ne nivelin rajonal, koordinatorete e perzgjedhur prej njesive vendore te kujdesit shëndetësor jane pergjegjes per koordinimin dhe menaxhimin lokal; marrjen e kiteve te testimit nga ISHP dhe shpërndarja e tyre ne çdo qender shëndetësore, pastaj mbledhja e mostrave / informacioneve, per tu derguar ne ISHP per ekzaminim laboratorik dhe se fundi shpërndarja e rezultateve laboratorike ne qendrat shëndetësore.

Ne nivelin e qendres se KSHP-se, drejtori dhe kryeinfermierja jane personi kryesor per programin; ata jane kujdesur per te gjithë koordinimin e aktiviteteve, duke filluar nga ftesa e grave dhe per te siguruar vazhdimin e gjithë aktiviteteve te parashikuara nga programi i depistimit. Ne disa zona urbane, personeli i qendrave te grave ka qene shume mbështetes per programin.

Gjinekologe te kualifikuar ne Spitalet e Universitetit te Tiranës kane ofruar kujdes te specializuar klinik per diagnozat dhe trajtimin e para-kancerit.

Ne programin kombetar te depistimit ka pasur nje perdorim me te madh nga ana e popullsisë se grave rurale. 58% e gjithë pjesëmarrësve jetojne ne zonat rurale. Ne menyre te ngjashme, programi eshte perdorur krahasimisht me shume nga grate me vetem arsim baze dhe ato te papuna. Duket se programi i depistimit terheq me shume komunitete rurale me probleme tradicionale te aksesit ne kujdes shëndetësor, ku grate jane me te interesuara per sherbimet baze shëndetësore falas dhe ku ato bashkepunojne me mire me personelin shëndetësor te KSHP-se. Nje model i ngjashem perdorimi te sherbimeve eshte verejtur edhe ne programin kombetar te kontrollit per personat 35-70 vjeç.

Prevalenca e pergjithshme e HPV me risk te larte midis pjesëmarrësve ne program ishte 6.1%, dhe ishte me e larte ne popullatat urbane te grave, si dhe midis atyre me arsim te larte, te punesuara dhe te pamartuara. Grate HPV pozitive raportuan te kene perdorur me shume

sherbimet e pap-testit ne te kaluaren, krahasuar me ato HPV negative. Meqenese grate HPV pozitive jane te nje klase me te larte socio-ekonomike dhe me urbane, ato mund te kene qene perdoruese me te shpeshta te nje sherbimi shendetesor, i cili eshte kryesisht oportunist dhe me kosto shtese. Grate e klasave me te uleta socio-ekonomike dhe ato te zonave rurale, ndersa kane duke treguar prevalence me te ulet te infeksionit HPV, kane qene me te prirura per te perdorur programin kombetar te depistimit, te terhequra nga mundesia e qasjes se tij te lehte dhe kostove te paperfilleshme.

Ne Tirane, Vlore, Lezhe, Gramsh, Gjirokaster dhe Devoll prevalenca e HPV ishte me e larta. Ne Has, Peqin, Permet, Malesi e Madhe dhe Kukes, u verejten popullatat me shkallen me te ulet te prevalences. Ndersa rrethprerja (cirkumcizio) e partnerit nuk ishte e lidhur me shanset e infektimit me HPV, pirja e duhanit nga gruaja duket te jete nje faktor i rendesishem qe rrit rrezikun e tij.

Kishte 6.5% te grave pjesemarrese ne program, te cilat ishin ne moshe me te madhe ose me te vogel se kategoria e moshes e parashikuar ne program (40-49 vjec). Ato gra shfaqnin nje prevalence me te larte te infeksionit HPV (7.1%). Perceptimi per rrezikun e tyre me te larte mund te kete kontribuar ne perfshirjen e ketyre grave ne program. Gjithashtu, kishte me shume se 5% te grave pjesemarrese, te cilat kishin bere testin HPV me pare, dhe ato nuk duhet te ishin ftuar per shqyrtim gjate vitit 2019.

81% e grave pjesemarrese HPV-pozitive kishin njohuri per parandalimin dhe 46% e tyre kishin njohuri per infeksionin HPV. Ne te dy rastet, shkalla e ndergjegjesimit rritej me nivelin arsimor. Shumica derrmuese e grave te intervistuar raportonin se jetonin brenda 20 minutash distance nga qendra shendetesore. Megjithate, per 33% prej tyre, rruga per ne qendren shendetesore mund te zgjasi 20 deri ne 40 minuta.

Si mjeku ashtu edhe infermierja e qendres shendetesore perfshihen ne ftesen dhe keshillimin e grave gjate depistimit primar. Shumica e ftesave jane bere nga vizitat ne shtepi dhe telefonatat.

Pothuajse 80% e grave kane marre informacionin e duhur gjate vizites primare te testimit.

Nje ne tre gra i kishte kerkuar mjekut ose mamise qe te ndihmonte ne marrjen e mostrave vaginale dhe grate me te reja ishin me te prirura per ta bere kete. Ata qe vendosen te merrnin mostren vete, perdoren dhomen e tualetit te qendres shendetesore per proceduren. Vetem nje pakice e vogel preferoi ta bente ate ne shtepite e tyre, dhe pastaj ta sillte mostren perseri ne qendren shendetesore ashtu siç ishte keshilluar.

Shumica e grave e gjeten proceduren e marrjes se mostres vaginale shume te thjeshte (60%) dhe aspak te dhimbshme (72%). Vetem 8% raportuan se ishte e veshtire dhe askush nuk tha se ishte shume e dhimbshme.

Koha mesatare nga testi primar i depistimit te momenti kur grate marrin rezultatin ishte 25 dite. 96% e grave moren rezultatet e tyre brenda kohes se premtuar te programit prej dy muajsh. 90% e grave shkuan per te marre rezultatin brenda 7 diteve nga momenti i kontaktimit. Te gjitha grate HPV-pozitive te pyetura shkuan ne qendren shendetesore per ta marre rezultatin e testit. Koha mesatare e keshillimit ne kujdesin shendetesor paresor per grate pozitive ishte rreth 20 minuta dhe vetem 6% e grave raportuan se ishin keshilluar ne menyre te pamjaftueshme (5 minuta ose me pak).

Deri ne mes te Djektorit 2019, rreth 90% e grave HPV pozitive ose kishin shkuar per vizite ekzaminuese ose po planifikonin te shkonin sa me shpejt te ishte e mundur. Ende rreth 10% e tyre hezitonin te shkonin. Duket se nuk ka ndonje vonese thelbeshore ne marrjen e kujdesit follow up, duke pasur parasysh se rreth 90% grave shkojne te gjinekologu brenda nje muaji nga momenti qe moren rezultatin e testit HPV. Koha mesatare nga marrja e rezultatit te testit deri ne viziten gjinekologjike per grate pozitive ishte vetem 6 dite.

Programi i depistimit duhet te perpiqet te mbaje ne minimum te gjitha shpenzimet nga xhepi; dekreti i qeverise shqiptare, mbi te cilin mbeshtetet programi, nenvizon se te gjitha sherbimet qe lidhen me depistimin primar dhe vizitat ne vijim te tij, ne sektorin publik jane falas ne piken e kujdesit. Personeli shendetesor eshte trajnuar per te informuar grate ne lidhje me kete, ne menyre qe te minimizojte te gjitha shpenzimet personale te evitueshme. Sidoqofte, me shume se nje ne tre gra qe kane kryer kolposkopi, kane zgjedhur kujdesin shendetesor privat per kete. Per me teper, 8% kane shkuar jashte vendit per ekzaminimet e rekomanduara, zakonisht ne Greqi dhe Itali. Shumica kane bere kolposkopine ne spitalet universitare gjinekologjike te Tiranes. Grate me arsim universitar ishin me te prirura te shkonin per nje vizite gjinekologjike ne nje institucion privat dhe vecanerisht jashte vendit.

Shumica e gjinekologeve (68%) kane rekomanduar teste te tjera gjate vizites se tyre follow up dhe gjysmes se grave pozitive i eshte rekomanduar ekzaminimi i citologjise dhe 15% ai i biopsise. Koha mesatare e kaluar te gjinekologu ishte 25 minuta. 4% e grave HPV-pozitive raportuan rezultate qe shkojne per para-kancer ose kancer, nderkohe qe 73% raportuan rezultate negative pas vizites se gjinekologut. Te tjerat raportuan ose probleme qe nuk shkonin per para kancer, ose nuk ishin te sigurta per kete. Frekuenca e para-kancerit ose kancerit e raportuar nga grate e intervistuar ishte e ngjashme me frekuencen e identifikuar ne regjistrat klinike ne Spitalin Universitar te Tiranes.

87% e grave pozitive raportuan shqetesime te rendesishme emocionale lidhur me rezultatin pozitiv.

Rreth 9 ne 10 e grave e vleresuan sherbimin e pergjithshem ne kujdesin shendetesor paresor, si dhe ne kujdesin e specializuar 'te mire' ose 'shume te mire'. Vetem, 10 % e grave e konsideruan ate 'mesatar' ose 'te keq'.

Metodologjia e vleresimit

Në këtë studim janë vlerësuar keto tregues kryesore:

1. Personeli i specializuar për kryerjen e kolposkopisë. Mjeke gjinekologe obstetere me trajnim në kolposkopi, marrjen e mostrave histologjike dhe trajtimin e lezioneve prekanceroze. Gjithashtu janë vlerësuar kapacitetet lidhur me mjeke cito-histopatolog me trajnim në citologji vaginale.
2. Ambjentet e nevojshme për kryerjen e vizites gjinekologjike dhe kolposkopisë
3. Aparatet kolposkopike dhe praktikantët e lidhura kolposkopine
4. laboratorët e cito-histopatologjisë të përshtatshëm për mostrat citologjike vaginale

Për sigurimin e informacionit janë intervistuar persona kyç me njohuri dhe eksperiencë në fushën e kapjes së hershme të kancerit të qafës së mitres ose menaxheret e spitaleve në 12 spitale rajonale të vendit.

Në aneks është një instrument i përdorur gjatë intervistave.

Në aneks gjithashtu janë personat kyç të intervistuar.

Matrica e kapaciteteve per kolposkopi ne spitalet rajonale dhe rekomandimet e detajuara

Spitali Rajonal Durres




Elementet e vleresimit	Kapacitete ekzistuese	Probleme, barriera	Komente, rekomandime
Sherbimi baze			
Sherbime per grate HPV pozitive ne depistim prane spitalit rajonal.	Klinika e obstetrike gjinekologjise prane Spitalit te Duresit ofron prej vitesh sherbim te kolposkopise per grate e rekomanduara nga kujdesi paresor. Kolposkopia eshte kryer si ekzaminim diagnoztikues lidhur me rastet me pap-test positive. Vitin e kaluar ka pasur edhe disa raste HPV-pozitive te rekomanduara per kolposkopi nga mjeku i familjes. Rastet qe perdorin sherbimin e spitalit te Duresit jane kryesisht nga zonat rurale.	Spitali ka qene pak i informuar mbi programin e ri te depistimit. Shume pak gra HPV-pozitive jane ekzaminuar ne Durres (2-3 raste). Shumica derrmuese preferojne ende spitalet gjinekologjike ne Tirane (ceshtje e besimit, njohurive dhe shqetesimi mbi semundjen). Grate rekomandohen per kolposkopi, por nuk keshillohen me hollesi se cila eshte qendra me e afert e specializuar. Pergjithesisht verehet nje renie graduale e rasteve te referuara ne spital gjate 10 viteve te fundit.	Nevojitet forcimi i koordinimit mes hallkave te sistemit shendetsor ne Durres; shendeti publik, sherbimet e kujdesit paresor dhe spitali rajonal. Nevojitet percaktimi formal i spitalit rajonal te Duresit si qender referimi per programin, duke perfshire Duresin, Kavajen dhe ndoshta Lushnjen.
Sherbime kolposkopie private ne qytet.	Ne qytet ekzaminimi i kolposkopise ofrohet edhe ne klinika private.	Praktika kryhet kryesisht nga mjeke gjinekologe te spitalit publik, qe punojne pasdite ne kliniken private. Mungon koordinimi formal mes	Nevojitet se pari rekomandimi i qarte nga mjeket e familjes te Duresit, Kavajes dhe Lushnjes per

		sherbimit publik dhe privat, lidhur me regjistrimin e rasteve.	te perdorur sherbimet publike te spitalit. Se dyti duhet rregulluar raportimi i rasteve te ekzaminuara ne spitalin publik.
Laboratori			
Laboratore per vleresimin histologjik ne spitalin rajonal.	Citologjia ne Spitalin e Duresit ka nje tradite te mire nga pervoja e grumbulluar gjate programeve pilot te para 12 viteve. Ne Dures per here te pare eshte aplikuar edhe citologjia me baze likuide. Nderkohe eshte forcuar 5 vitet e fundit sherbimi i anatomise patologjike qe funksionon prane spitalit publik. Ka pajisjet dhe personelin e nevojshem. Ky sherbim eshte i pavarur prej sherbimit te gjinekologjise dhe per shkembimin e mostrave dhe pergjigjeve aplikohet nje rregullore e caktuar e miratuar nga drejtoria e spitalit.	Raportohen barriera financiare lidhur me perdorimin e anatomise patologjike. Ne opinionin e specialisteve keto jo vetem vonojne mbylljen e ciklit te diagnozes dhe trajtimit te shpejte, por edhe cenojne besimin e perdoruesve tek sistemi. Gjithashtu raportohet nevoja per permiresimin e kapaciteteve ne laboratorin e infeksioneve seksualisht te trasmetueshme.	Nevojitet nje udhezim per perjashtimin nga kostot e anatomise patologjike per gjithë grave HPV-pozitive te identifikuara nga programi dhe qe kryejne kolposkopnine ne spitalin rajonal te Duresit.
Laboratore private.	Sherbimi i citologjise apo edhe i testit HPV ofrohet edhe privat, por kryesisht ne Tirane.	Nuk ka probleme evidente, me perjashtim te distancave dhe kostove shtese ne transport per grate qe zgjedhin sherbimin privat. Gjithashtu ofrimi i testit te tipizimit te HPV, si ekzaminim shtese, per grate HPV positive ne depistim, ne laboratore private, rrit shume dhe ne menyre te panevojshme kostot per grate.	Nevojitet nje informim me i mire i grave HPV-pozitive mbi menyren e funksionimit te programit, sherbimet e nevojshme dhe ato qe nuk jane te nevojshme. Nevojitet caktimi i infermiereve te dedikuara per mbeshtetjen e grave HPV positive ne hallkat

			e sistemit.
Personeli			
Personel i trajnuar dhe i afte qe te kryeje ekzaminim kolposkopik (si dhe mostra per biopsi dhe histopatologji) ne spital.	Nje mjeke gjinekologe eshte e specializuar dhe ka pervoje shume vjecare ne kryerjen e ekzaminimit kolposkopik. Gjithashtu praktikon edhe nje mjeke gjinekologe e re. Aplikohen si procedura per biopsine cervikale, ashtu edhe kyretazhi endocervical	Nuk ka probleme evidente lidhur me pranine e personelit te afte per kryerjen e ekzaminimit kolposkopik, me perjashtim te numrit te ulet te ekzaminimeve te kryera ne vit. Ky tregues mund te cenoje standartet e cilesise se sherbimit ne te ardhmen.	Eshte i nevojshem aprovimi i hartes se spitaleve qe ofrojne sherbime kolposkopie dhe popullatave, rretheve apo qarqeve qe ato duhet te mbulojne.
Personel i trajnuar dhe i afte qe te kryeje trajtimin e lezioneve pre-kanceroze ne spitalin publik.	Nje mjeke gjinekologe eshte e specializuar ne kete fushe dhe ka pervoje shume vjecare ne kryerjen e trajtimit te lezioneve pre-kanceroze. LEEP praktikohet per CIN1-CIN2. Per rastet e CIN3 apo kancer in situ, praktikohet heqja e mitres.	Ngelet problem anashkalimi i sherbimit publik ne kete fushe dhe zgjedhja e spitaleve te Tiranes, apo spitaleve jashte vendit. Arsyet jane te lidhura me informimin dhe ndergjegjesimin jo te mire te popullates mbi kapacitetet e spitalit te Duresit. Gra te zonave rurale dhe kategorite me te varfera perbejne shumicen e pacienteve te spitalit.	Pervec rekomandimit me siper, eshte gjithashtu e nevojshme te rritet niveli i ndergjegjesimit te grave dhe te detajohen me mire rekomandimet nga mjeket e familjes
Personel per trajtimin e lezioneve pre kanceroze, private ne qytet.	Personeli i spitalit publik		
Pajisjet			
Materiale dhe pajisje per kryerjen e ekzaminimeve kolposkopike.	Jane ne gjendje te mire pune dy kolposkope. Gjithashtu ekzistojne dy hapesira per kryerjen e ekzaminimit, te pajisura me infrastrukturen e nevojshme; Shtrat ekzaminimi qe lejon ekzaminime ne futjen e	Ne spital jane duke u bere nderhyrje ne infrastrukture, prej termetit te nentorit 2019. Futja e sherbimit te pediatrie prane spitalit gjinekologjik, ka shkaktuar veshtiresi te cilat konsiderohen te	Nuk ka nevoja acute per nderhyrje, megjithate eshte e nevojshme te sigurohet mbeshtetje afatgjate me mjete konsumi dhe te

	spekulumit ne cervix Spekulum dyvalent Instrumenta per punch biopsy, Kyreta endocervical Burim drite qe lejon ekzaminimin e cervixit.	perkoheshme nga personeli.	kryhet mirembajtja e pajisjeve dhe e mjediseve perkates
Referimi			
Referimi i rasteve te dyshuara per kancer. Protokolle referimi.	LEEP praktikohet per CIN1-CIN2. Per rastet e CIN3 apo kancer in situ, pratikohet heqja e mitres ne Spialin e Duresit. Rastet e tjera me kancer me te avancuar referohen urgjent ne Spitalin Universitar Nene Tereza, Sherbimi i onkologjise.	Nuk ka probleme apo barriera evidente ne procesin e referimit. Megjithate nuk ka nje protokoll specifik se cilat raste referohen dhe cilat jo.	Spitali i Duresit do te perfitonte nga rishikimi i udherrefyesve kombetare mbi rolin e spitaleve rajonale ne trajtimin e pre- kancereve dhe kancereve, si dhe sistemin e referimit ne kete fushe.
Regjistrimi			
Sistemi i regjistrimit te rasteve (kolposkopi, trajtime, referime etj).	Perdoret regjistri i pacienteve, jo ne forme elektronike.	Nuk shenohet ne regjister nese gruaja e ekzaminuar eshte referuar ne kuader te programit kombetar te depistimit apo jo. Kjo veshtireson vleresimin e situates dhe perllogaritjen e indikatoreve te programit.	Nevojitet standardizimi i regjistrimit te kolposkopise prane spitaleve rajonale dhe shkembimi sistematik i informacionit me Operatoret Shendetesore dhe Institutin e Shendetit Publik.

Spitali Rajonal Fier




Elementet e vleresimit	Kapacitete ekzistuese	Probleme, barriera	Komente, rekomandime
Sherbimi baze			
Sherbime per grate HPV pozitive ne depistim prane spitalit rajonal.	Klinika e obstetrike gjinekologjise prane Spitalit te Fierit ka vijuar te ofroje prej vitesh sherbim te kolposkopise per grate qe rezultonin positive ne pap-test, si dhe per grate e rekomanduara nga kujdesi paresor. Vitin e kaluar ka pasur edhe nje numer rastesh HPV-pozitive te rekomanduara per kolposkopi nga mjeku i familjes ne kuader te programit kombetar te depistimit.	Spitali ka qene pak i informuar mbi programin e ri te depistimit. Shume pak gra HPV-pozitive jane ekzaminuar ne Fier (me pak se 10 raste). Shumica derrmuese preferojne ende spitalet gjinekologjike ne Tirane. Grate nuk e dine mire se cfare cilesise sherbimi ofrohet ne Spitalin e Fierit. Shqetesimi i larte mbi semundjen mund te ndikojte gjithashtu per zgjedhjen e spitaleve te Tiranes ose edhe Klinikave jashte vendit. Grate rekomandohen per kolposkopi, por nuk keshillohen me hollesi se cila eshte qendra me e afert e specializuar.	Nevojitet forcimi i koordinimit mes hallkave te sistemit shendetsor ne Rajonin e Fierit; shendeti publik, sherbimet e kujdesit paresor dhe spitali rajonal duhet te shlembejne informacion. Grate duhet te rekomandohen ne menyre specifike mbi Spitaline Fierit. Nevojitet percaktimi formal i spitalit rajonal te Fierit si qender referimi per programin, duke perfshire Vloren, Mallakastren dhe ndoshta rrethe te tjera ne jug te vendit.

Sherbime kolposkopie private ne qytet.	Ne qytet ekzaminimi i kolposkopise mund ofrohet edhe ne klinika private.	Praktika kryhet kryesisht nga mjeke gjinekologe te spitalit publik ose qendres se gruas ne kujdesin paresor, qe punojne pasdite ne kliniken private. Mungon koordinimi formal mes sherbimit publik dhe privat, lidhur me regjistrimin e rasteve.	Nevojitet se pari rekomandimi i qarte nga mjeket e familjes te Fierit, Vlores dhe Mallakastres per te perdorur sherbimet publike te spitalit Fier. Se dyti duhet rregulluar raportimi i rasteve te ekzaminuara ne spitalin publik.
Laboratori			
Laboratore per vleresimin histologjik ne spitalin rajonal.	Ne Spitalin e Fierit ka nje strukture te dedikuar marrjes se materialit citologjik per pap-test, si dhe laborator te specializur te anatomise patologjike per mostrat vaginale.	Tradicionalisht mostrat jane ekzaminuar ne Fier per ekzaminim histologjik. Gjithashtu me pare, ne Fier eshte kryer edhe ekzaminimi per biopsi.	Fillimi I modelit te ri te sherbimit laboratorik prane spitaleve te do te perfshije edhe ekzaminimin e metejshe lidhur me citologjine dhe histologjine patologjike per diagnozen se grave qe rezultojne positive per HPV.
Laboratore private.	Sherbimi i citologjise apo edhe i testit HPV ofrohet edhe privat, por kryesisht ne Tirane.	Nuk ka probleme evidente, me perjashtim te distancave dhe kostove shtese ne transport per grate qe zgjedhin sherbimin privat. Gjithashtu ofrimi i testit te tipizimit te HPV, si ekzaminim shtese, per grate HPV pozitive ne depistim, ne laboratore private, rrit shume dhe ne menyre te panevojshme kostot per grate.	Nevojitet nje informim me i mire i grave HPV-pozitive mbi menyren e funksionimit te programit, sherbimet e nevojshme dhe ato qe nuk jane te nevojshme. Nevojitet caktimi i infermiereve te dedikuara per mbeshtetjen e grave HPV pozitive ne hallkat e sistemit.
Personeli			

Personel i trajnuar dhe i afte qe te kryeje ekzaminim kolposkopik (si dhe mostra per biopsi dhe histopalogji) ne spital.	Nje mjek gjinekolog eshte i specializuar dhe ka pervoje shume vjecare ne kryerjen e ekzaminimit kolposkopik. Gjithashtu praktikojne edhe dy mjeke gjinekologe te tjere. Mund te aplikohen si procedura per biopsine cervikale, ashtu edhe kyretazhi endocervical	Problem ngelet numri i ulet te ekzaminimeve te kryera ne vit. Ky tregues mund te cenoje standartet e cilesise se sherbimt ne te ardhmen. Nuk ka probleme evidente lidhur me pranine e personelit te afte per kryerjen e ekzaminimit kolposkopik.	Per te rritur performancen si edhe cilesine e ekzaminimit ne vijimes, eshte i nevojshem aprovimi i hartes se spitaleve qe ofrojne sherbime kolposkopie dhe popullatave, rretheve apo qarqeve qe ato duhet te mbulojne.
Personel i trajnuar dhe i afte qe te kryeje trajtimin e lezioneve pre-kanceroze ne spitalin publik.	Nje mjek gjinekologe eshte e specializuar ne kete fushe dhe ka pervoje ne kryerjen e trajtimit te lezioneve pre-kanceroze. Mund te praktikohet LEEP per CIN1-CIN2. Per rastet e CIN3 apo kancer in situ, rekomandohet rasti ne spitalet universitare.	Ngelet problem anashkalimi i sherbimit publik ne kete fushe dhe zgjedhja e spitaleve te Tiranës, apo spitaleve jashte vendit. Arsyt jane te lidhura me informimin dhe ndergjegjesimin jo te mire te popullates mbi kapacitetet e spitalit te Fierit.	Perverc rekomandimit me siper, eshte gjithashtu e nevojshme te rritet niveli i ndergjegjesimit te grave dhe te detajohen me mire rekomandimet nga mjeket e familjes
Personel per trajtimin e lezioneve pre kanceroze, private ne qytet.	Personeli i spitalit publik, qendres se gruas ose mjeke ne pension.		
Pajisjet			
Materiale dhe pajisje per kryerjen e ekzaminimeve kolposkopike.	Ekziston kolposkopi ne gjendje te mire pune. Gjithashtu ekzistojn hapesira per kryerjen e ekzaminimit, e pajisur me infrastrukturen e nevojshme; Shtrat ekzaminimi qe lejon ekzaminime ne futjen e spekulumit ne cervix Spekulum dyvalent Instrumenta per punch biopsy, Kyreta endocervical Burim drite qe lejon	Mjediset e infrastruktures jane te pershtatshme per ekzaminimet kolposkopike. Problem ngelet numri i ulet i ekzaminimeve dhe pasojat ne performance dhe sigurim cilesise qe vijne per kesaj.	Nuk ka nevoja akute per nderhyrje, megjithate eshte e nevojshme te sigurohet mbeshtetje afatgjate me mjete konsumi dhe te kryhet mirembajtja e pajisjeve dhe e mjediseve perkates

	ekzaminimin e cervixit.		
Referimi			
Referimi i rasteve te dyshuara per kancer. Protokolle referimi.	LEEP mund te praktikohet per CIN1-CIN2. Per rastet e CIN3, kancer in situ, si dhe rastet e tjera me kancer me te avancuar referohen ne Spitalet Universitare Gjinekologjike ne Tirane ose ne Spitalin Universitar Nene Tereza, Sherbimi i onkologjise.	Nuk ka probleme apo barriera evidente ne procesin e referimit. Megjithate nuk ka nje protokoll specifik se cilat raste referohen dhe cilat jo.	Spitali i Fierit do te perfitonte nga rishikimi i udherrefyesve kombetare mbi rolin e spitaleve rajonale ne trajtimin e pre-kancereve dhe kancereve, si dhe sistemin e referimit ne kete fushe.
Regjistrimi			
Sistemi i regjistrimit te rasteve (kolposkopi, trajtime, referime etj).	Perdoret regjistri i pacienteve, jo ne forme elektronike.	Nuk shenohet ne regjister nese gruaja e ekzaminuar eshte referuar ne kuader te programit kombetar te depistimit apo jo. Kjo veshtireson vleresimin e situates dhe perlllogaritjen e indikatorëve te programit.	Nevojitet standardizimi i regjistrimit te kolposkopise prane spitaleve rajonale dhe shkembimi sistematik i informacionit me Operatoret Shendetesore dhe Institutin e Shendetit Publik.

Spitali Rajonal Shkoder




Elementet e vleresimit	Kapacitete ekzistuese	Probleme, barriera	Komente, rekomandime
Sherbimi baze			
Sherbime per grate HPV pozitive ne depistim prane spitalit rajonal.	Klinika e obstetrike gjinekologjise prane Spitalit te Shkodres ka vijuar te ofroje prej vitesh sherbim te kolposkopise per grate qe rezultojne positive ne pap-test, si dhe per grate e rekomanduara nga kujdesi paresor. Eshte e veshtire te konfirmohet nese ka pasur vitin e kaluar raste HPV-pozitive ne kuader te programit kombetar te depistimit, te rekomanduara per kolposkopi nga mjeku i familjes.	Spitali ka qene pak i informuar mbi programin e ri te depistimit. Nuk ka informacion mbi gra HPV-pozitive qe te jene ekzaminuar ne Shkoder. Shumica derrmuese preferojne ende spitalet gjinekologjike ne Tirane. Grate nuk e dine mire se cfare cilesise sherbimi ofrohet ne Spitalin e Shkodres. Shqetesimi i larte mbi semundjen mund te ndikojte gjithashtu per zgjedhjen e spitaleve te Tiranes ose edhe Klinikave jashte vendit. Grate rekomandohen per kolposkopi, por nuk keshillohen me hollesi se cila eshte qendra me e afert e specializuar.	Nevojitet forcimi i koordinimit mes hallkave te sistemit shendetsor ne Rajonin e Shkodres; shendeti publik, sherbimet e kujdesit paresor dhe spitali rajonal duhet te shlembejne informacion. Grate duhet te rekomandohen ne menyre specifike mbi Spitalin e Shkodres. Nevojitet percaktimi formal i spitalit rajonal te Shkodres si qender referimi per programin, duke perfshire Pukun, Malesine e Madhe dhe ndoshta Mirditen.

Sherbime kolposkopie private ne qytet.	Ne qytet ekzaminimi i kolposkopise mund ofrohet edhe ne klinika private.	Praktika mund te kryhet nga mjeke gjinekologe te spitalit publik, qe punojne pasdite ne kliniken private. Mungon koordinimi formal mes sherbimit publik dhe privat, lidhur me regjistrimin e rasteve.	Nevojitet se pari rekomandimi i qarte nga mjeket e familjes te Shkodres, Malesise se Madhe dhe Pukes per te perdorur sherbimet publike te spitalit Shkoder. Se dyti duhet rregulluar raportimi i rasteve te ekzaminuara ne spitalin publik.
Laboratori			
Laboratore per vleresimin histologjik ne spitalin rajonal.	Ne Spitalin e Shkodres ka strukture te pershtatshme per marrjen e materialit citologjik per pap-test, por jo laborator te specializur te anatomise patologjike per mostrat vaginale.	Tradicionalisht mostrat jane derguar ne Tirane per ekzaminim histologjik. Shpesh nje pjese e madhe e kostove dhe e logjistikës se sherbimit bie mbi grate qe perdorin sherbimin. Raportohen barrierat financiare lidhur me perdorimin e anatomise patologjike.	Shpresohet se fillimi I modelit te ri te sherbimit laboratorik prane spitaleve te zgjidhe kete komponent te ekzaminimit te metejshem dhe diagnozes se grave qe rezultojne positive per HPV. Koncesioni i laboratoreve spitalore perfshin edhe citologjine dhe histologjine patologjike.
Laboratore private.	Sherbimi i citologjise apo edhe i testit HPV ofrohet ne laboratore privat, por kryesisht ne Tirane.	Distanca dhe kostot shtese ne transport per grate qe zgjedhin sherbimin privat jane nje barriere sinjifikative. Gjithashtu ofrimi i testit te tipizimit te HPV, si ekzaminim shtese, per grate HPV pozitive ne depistim, ne laboratore private, rrit shume dhe ne menyre te panevojshme kostot per grate.	Nevojitet nje informim me i mire i grave HPV-pozitive mbi menyren e funksionimit te programit, sherbimet e nevojshme dhe ato qe nuk jane te nevojshme. Nevojitet caktimi i infermiereve te dedikuara per mbeshtetjen e

			grave HPV positive ne hallkat e sistemit.
Personeli			
Personel i trajnuar dhe i afte qe te kryeje ekzaminim kolposkopik (si dhe mostra per biopsi dhe histopalogji) ne spital.	Jane disa mjeke gjinekolog te specializuar dhe me pervoje ne kryerjen e ekzaminimit kolposkopik. Mund te aplikohen si procedura per biopsine cervikale, ashtu edhe kyretazhi endocervical	Nuk ka probleme evidente lidhur me pranine e personelit te afte per kryerjen e ekzaminimit kolposkopik. Problem ngelet numri i ulet te ekzaminimeve te kryera ne vit. Ky tregues mund te cenoje standartet e cilesise se sherbimit ne te ardhmen.	Per te rritur si performancen, ashtu edhe cilesine e ekzaminimit ne vijimes, eshte i nevojshem aprovimi i hartes se spitaleve qe ofrojne sherbime kolposkopie dhe popullatave, rretheve apo qarqeve qe ato duhet te mbulojne.
Personel i trajnuar dhe i afte qe te kryeje trajtimin e lezioneve pre-kanceroze ne spitalin publik.	Ka mjeke gjinekologe te specializuar ne kryerjen e trajtimit te lezioneve pre-kanceroze. Mund te praktikohet LEEP per CIN1-CIN2. Per rastet e CIN3 apo kancer in situ, rekomandohet rasti ne spitalet universitare.	Ngelet problem anashkalimi i sherbimit publik ne kete fushe dhe zgjedhja e spitaleve te Tiranes, apo spitaleve jashte vendit. Arsytet jane te lidhura me informimin dhe ndergjegjesimin jo te mire te popullates mbi kapacitetet e spitalit te Shkodres	Pervet rekomandimit me siper, eshte gjithashtu e nevojshme te rritet niveli i ndergjegjesimit te grave dhe te detajohen me mire rekomandimet nga mjeket e familjes
Personel per trajtimin e lezioneve pre kanceroze, private ne qytet.	Personeli i spitalit publik, ose mjeke ne pension.		
Pajisjet			
Materiale dhe pajisje per kryerjen e ekzaminimeve kolposkopike.	Ekziston kolposkopi. Gjithashtu ekziston hapesira per kryerjen e ekzaminimit, e pajisur me infrastrukturen e nevojshme; Shtrat ekzaminimi qe lejon ekzaminime ne futjen e spekulumit ne cervix Spekulum dyvalent Instrumenta per punch	Mjediset e infrastruktures jane te pershtatshme per ekzaminimet kolposkopike. Problem ngelet numri i ulet i ekzaminimeve dhe pasojat ne performance dhe sigurim cilesise qe vijne per kesaj.	Nuk ka nevoja akute per nderhyrje, megjithate eshte e nevojshme te sigurohet mbeshtetje afatgjate me mjete konsumi dhe te kryhet mirembajtja e

	biopsy, Kyreta endocervical Burim drite qe lejon ekzaminimin e cervixit.		pajisjeve dhe e mjediseve perkates
Referimi			
Referimi i rasteve te dyshuara per kancer. Protokolle referimi.	LEEP mund te praktikohet per CIN1-CIN2. Per rastet e CIN3, kancer in situ, si dhe rastet e tjera me kancer me te avancuar referohen ne Spitalet Universitare Gjinekologjike ne Tirane ose ne Spitalin Universitar Nene Tereza, Sherbimi i onkologjise.	Nuk ka probleme apo barriera evidente ne procesin e referimit. Megjithate nuk ka nje protokoll specifik se cilat raste referohen dhe cilat jo.	Spitali i Shkodres do te perfitonte nga rishikimi i udherrefyesve kombetare mbi rolin e spitaleve rajonale ne trajtimin e pre- kancereve dhe kancereve, si dhe sistemin e referimit ne kete fushe.
Regjistrimi			
Sistemi i regjistrimit te rasteve (kolposkopi, trajtime, referime etj).	Perdoret regjistri i pacienteve, jo ne forme elektronike.	Nuk shenohet ne regjister nese gruaja e ekzaminuar eshte referuar ne kuader te programit kombetar te depistimit apo jo. Kjo veshtireson vleresimin e situates dhe perllogaritjen e indikatoreve te programit.	Nevojitet standardizimi i regjistrimit te kolposkopise prane spitaleve rajonale dhe shkembimi sistematik i informacionit me Operatoret Shendetesore dhe Institutin e Shendetit Publik.

Spitali Rajonal Vlore




Elementet e vleresimit	Kapacitete ekzistuese	Probleme, barriera	Komente, rekomandime
Sherbimi baze			
